

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **DOGANA E KOSOVES**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **201/13300-26-2773-1-1-1**

Sa i përket tenderit për: **'Furnizim me pllomba për Doganën e Kosovës'**
Pjesa 1: Furnizim me pllomba me gjatesi te kablllos 30cm

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

PROGLOBAL SHPK

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Dardani, Rr. 28 Nentori, LI-2, Lok 129

(Vendi)

Prishtinë

(Vendi)

10000

(Kodi postar)

044148645

(Numri Telefonit)

Latif Imeri

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@proglobal-ks.com

(Adresa elektronike)

31.08.2025

(Data e parashtrimit të ankesës)



(Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- | | |
|-------------------------------------|--------------|
| - Hapja e ofertave | – 06.07.2026 |
| - Njoftimi mbi vendimin e AK-se | – 12.08.2026 |
| - Kërkesa për rishqyrtim | - 17.08.2026 |
| - Vendimi për shqyrtimin e kërkesës | – 21.08.2026 |

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☒

Jo ☐

- | |
|-----------------------|
| - Me datën 06.07.2026 |
|-----------------------|

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Operatori Ekonomik ankues “Pro Global” shpk – Prishtine, me datën 17.08.2026, bazuar ne dispozitat e nenit 108/A, te LPP-se dhe ne afatin paraparë me LPP, e ka kundërshtuar vendimin e AK – Dogana e Kosoves, përkatësisht vendimin per dhenie te kontrates dhe arsyetimin e eliminimit te ofertës sonë sipas letres standarde, megjithatë AK, me vendimin e datës 21.08.2026, ka refuzuar kërkesën tone përkundër faktit se ne si OE kemi prezantuar prova konkrete përmes te cilave vërtetohet se kemi ofertuar si te pergjegjeshem.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Shkeljet ligjore te LPP-se dhe akteve tjera nen ligjore.

- Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
- Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi
- Neni 28 Specifikimet teknike
- Neni 52 Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës
- Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
- Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale
- Neni 71 Grupet e Operatorëve Ekonomik dhe Operatorët e Huaj Ekonomik
- Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

Rregullorja për Prokurim Publik, 001/2022

- Neni 17 Dosja e tenderit
- Neni 97 Shkeljet e renda.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Te nderuar,

Me datën 21.08.2026, neve si kompani kemi pranuar njoftimin mbi vendimin për shqyrtimin e kërkesës si AK, me qëllim eliminimi të kompanisë tona në mënyrë të kunderligjeshme nga procedura e prokurimit, prandaj ne kuptim të nenit 108/A dhe brenda afatit të parapare me LPP, paraqesim kunderargumentet tona si më poshtë:

PRETENDIMI ANKIMOR 1

Eliminimi i kundërligjshëm i Grupit të Operatorëve Ekonomikë për shkak të mosvlerësimit të dëshmitë të anëtarit të konzorciumit

Autoriteti Kontraktues – Dogana e Kosovës, përmes letrës standarde, ka tentuar të arsyetojë eliminimin e ofertës sonë duke konstatuar se:

“Lista e dorëzuar nga OE për furnizime kryesore relevante (pllomba) nuk përmban asnjë furnizim me pllomba... furnizimet e paraqitura kanë të bëjnë me pajisje për mbrojtje nga zjarri.”

Ky konstatim është faktikisht i pasaktë dhe rezultat i një vlerësimi jo të plotë të dokumentacionit të dorëzuar me ofertën tonë.

Në këtë procedurë të prokurimit kemi ofertuar si **Grup i Operatorëve Ekonomikë (Konzorcium)**, i përbërë nga:

- **“PROGLOBAL” SH.P.K. – Lider i Grupit;**
- **“Shandong Haoyu Security Technology Co., Ltd.” – Anëtar i Grupit dhe prodhues i mallrave të ofruara.**

Në kuadër të ofertës së dorëzuar, anëtari i grupit **“Shandong Haoyu Security Technology Co., Ltd.”** ka paraqitur dëshmi konkrete dhe drejtpërdrejt relevante lidhur me furnizimin me pllomba, përkatësisht referencën e lëshuar nga blerësi **“Road Master Importer”**, të datës **29.06.2026**, për realizimin e kontratës me lëndë:

“Supplying 1.7 million cable seals” – Furnizim me 1.7 milionë pllomba me kablo,
në vlerë totale prej **124,100.00 USD**.

Pra, në kundërshtim të drejtpërdrejtë me konstatimin e AK-së se lista/dëshmitë e dorëzuara *“nuk përmbajnë asnjë furnizim me pllomba”*, oferta jonë përmban dëshmi specifike për furnizimin e **1.7 milionë pllombave me kablo**, të realizuar pikërisht nga anëtari i konzorciumit dhe njëkohësisht prodhuesi i produktit të ofruar.

Vlera e kësaj reference është **124,100.00 USD**, dhe si e tillë përmbush/tejkalon kërkesën minimale të përcaktuar në **pikën 9.1.a të FDT-së**, ku është kërkuar vlera minimale e furnizimeve relevante prej **70,000.00 EUR**.

Fakti që lideri i grupit, PROGLOBAL SH.P.K., ka paraqitur edhe kontrata/referenca të tjera, përfshirë furnizime me pajisje për mbrojtje nga zjarri, nuk mund të përdoret si bazë për të injoruar dëshmitë relevante të paraqitura nga anëtari tjetër i grupit.

Në një ofertë të paraqitur nga një Grup i Operatorëve Ekonomikë, përmbushja e kërkesave për kapacitet teknik dhe profesional duhet të vlerësohet duke marrë në konsideratë kapacitetet dhe dëshmitë e anëtarëve të grupit në përputhje me dispozitat e LPP-së që rregullojnë grupet e operatorëve ekonomikë dhe kapacitetin teknik/profesional.

Rrjedhimisht, AK nuk ka pasur bazë që gjatë vlerësimit të kufizohet vetëm në kontratat apo referencat e liderit të grupit, duke anashkaluar dokumentacionin e anëtarit tjetër të konzorciumit, veçanërisht kur ky anëtar është **prodhuesi i pllombave të ofruara** dhe ka paraqitur dëshmi të drejtpërdrejtë për realizimin e një furnizimi të së njëjtës natyrë.

Për më tepër, në kuptim të **nenit 59 të LPP-së**, gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve, Autoriteti Kontraktues ka për obligim të vlerësojë ofertën dhe dokumentacionin e dorëzuar në tërësinë e tij. Në rastin konkret, komisioni vlerësues ka bërë një vlerësim të mangët dhe të njëanshëm, duke marrë në konsideratë vetëm një pjesë të dokumentacionit të liderit të grupit dhe duke **injoruar plotësisht dëshminë relevante për furnizim me pllomba të paraqitur nga anëtari tjetër i konzorciumit.**

Një vlerësim i tillë cenon vetë parimin e ofertimit si grup i operatorëve ekonomikë, sepse praktikisht AK ka trajtuar liderin e grupit sikur të kishte ofertuar i vetëm, ndërkohë që oferta është dorëzuar nga një konzorcium dhe kapacitetet e tij duhet të vlerësohen sipas mënyrës së paraparë për grupet e operatorëve ekonomikë.

Prandaj, konstatimi i AK-së se *“lista e dorëzuar nga OE për furnizime kryesore relevante (pllomba) nuk përmban asnjë furnizim me pllomba”* është **qartazi i kundërshtuar nga vetë dokumentacioni që gjendet në ofertën tonë.**

Sikur AK të kishte bërë ekzaminimin e plotë të dokumentacionit të tenderit, do të kishte konstatuar se anëtari i konzorciumit ka paraqitur referencë për **1.7 milionë pllomba me kablo në vlerë prej 124,100.00 USD**, dhe rrjedhimisht nuk do të mund të arrinte në përfundimin se nuk është paraqitur asnjë furnizim relevant me pllomba.

Për këto arsye, konsiderojmë se eliminimi i ofertës sonë mbi këtë bazë është **i pabazuar në gjendjen faktike, rezultat i mosvlerësimit të plotë të dokumentacionit të ofertës dhe në kundërshtim me dispozitat e LPP-së që rregullojnë ekzaminimin e tenderëve, kapacitetin teknik/profesional dhe ofertimin nga grupet e operatorëve ekonomikë.**

Kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që këtë pretendim ankimor ta aprovojë si **të bazuar**, të konstatojë se Autoriteti Kontraktues ka vepruar gabimisht duke mos marrë në konsideratë dëshminë/referencën e anëtarit të konzorciumit **“Shandong Haoyu Security Technology Co., Ltd.”**, dhe të obligojë Autoritetin Kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertës të marrë në konsideratë **të gjitha dëshmitë e dorëzuara nga të gjithë anëtarët e Grupit të Operatorëve Ekonomikë.**

PROVAT:

1. Kopja e kontratës/referencës së “Shandong Haoyu Security Technology Co., Ltd.” për furnizimin me 1.7 milionë cable seals;
2. Referenca e blerësit “Road Master Importer”, datë 29.06.2026;
3. Referenca e PROGLOBAL SHPK per blloba
4. Lista e furnizimeve të realizuara e dorëzuar në ofertë;
5. Marrëveshja/Deklarata për formimin e Grupit të Operatorëve Ekonomikë;
6. Pika 9.1.a e FDT-së;

የጉልበት አስመጪ
Road Master Importer

☎ 0943 88 96 68/0911 23 96 12 Email: - abdellaebrahim44@gmail.com

REFERENCE LETTER

Purchaser :Roadmaster importer

Supplier :Shandong Haoyu Security Technology Co., Ltd.

Contract subject and no :Supplying 1.7 million cable seals.

Contract value :124100 USD

Time and place of contract completion: Since the 26.08.2025

Contract is correctly executed: Until now the amount of 1.7 million pcs cable seals have been delivered and all obligations of the contract have been completed and executed on time and in accordance with contract obligations specified standarts and requirements. Contract is completed.

29.06.2026

+251911239612

abdellaebrahim44@gmail.com



FleteDergesa/ Waybills

004598

Date:

24.07.2025

PROGLOBAL SHPK

Rr. 28 Nentori, Li-2, Lok. 3/1

10 000 Prishtinë

proglobal.ks@gmail.com

www.proglobal-ks.com

Nr. Unik Identifikues: 811500794

Nr. TVSH: 330471524

Tel: +383 44 148 645

Klienti: KEK sh.a.

Vendi i dergeses: Depo TCA, Obiliq

Projekti : Furnizim me pjesë për zjarrrfakës

Kontrata : nr.4259 dt.27.06.2025

Nr i prokurimit : KEKO-25-048-121

Pershkrimi/Description	Njesia/Unit	Sasia/Qty
Manometra per AKZ (P-6-9) me shtypje VT2600 konstante (ekuivalent)	copë	200
Ventili per AKZ per shtypje konstant(P) VT0004 (ekuivalent)	copë	200
Dikton imbeshtetes ventili per AKZ (P) me shtypje konstante VT0400 (ekuivalent)	copë	400
Gyp EPDM komplet me fiskaje per AKZ tip CO2 - 5 (ekuivalent)	copë	50
Gyp EPDM komplet me fiskaje per AKZ tip CO2 - 10 (ekuivalent)	copë	50
Trake tefloni e gjere	copë	50
Bilomba plumbi	kg	10
Siguresa te plastakes per AKZ S-6 dhe S-9 (tipi i ap. pastor)	copë	500
Gypa per AKZ, P-6,SM0011(tipi i ap. pastor) SM0013	copë	150
Gypa per AKZ, P-9,SM0011(tipi i ap. pastor) SM0014	copë	150
Etiketa (sipas mostres)	copë	5000
Sprej per lirim	copë	50
Valvula per bombola te CO2-45 per sis. automatik (ekuivalent). Valvula duhet te jete e pershtateshme per sistemet aktuale te montuara ne KEK dhe duhet te permbush karakterist. ne vijimi. Menyra e aktivizimit :manuel, pneumatik ose kapsol plasese. Piletimi i jash	copë	20



Pavaresisht këtyre fakteve dhe provave AK, tenton te eliminojofertën tone ne mënyrë arbitrare dhe kundërligjore, ku veprimet e AK, gjegjesisht anetareve te komisionit vleresues dhe zyrtarit përgjegjës te prokurimit konfirmojne kjarte shkeljen e parimeve bazike te prokurimit publik.

PRETENDIMI ANKIMOR 2

Eliminimi i kundërligjshëm për shkak të logos dhe numrit tetëshifror në mostrën fizike

Autoriteti Kontraktues – Dogana e Kosovës, në arsyetimin për eliminimin e ofertës sonë, ka konstatuar se:

“Mostra e dorëzuar nuk përmbush kërkesat e përcaktuara në Aneksin 1... pasi që mostra nuk përmban logo zyrtare të Doganës së Kosovës dhe nuk e ka numrin tetë shifror të gravuar.”

Ky konstatim dhe interpretimi që AK i ka bërë mostrës së dorëzuar është i pabazuar dhe nuk paraqet vlerësim objektiv të përputhshmërisë teknike të produktit të ofruar.

Mostra fizike e dorëzuar nga Grupi ynë i Operatorëve Ekonomikë përputhet me karakteristikat esenciale teknike, fizike, konstruktive dhe mekanike të produktit të kërkuar në Aneksin 1, përfshirë materialin e trupit, dimensionet, karakteristikat e kabllot, gjatësinë e saj prej **30 cm**, mekanizmin e bllokimit kundër kthimit prapa dhe kërkesat e standardit **ISO 17712:2013**, përputhshmëria me të cilin është dëshmuar edhe përmes raportit të testimit të lëshuar nga laborator i akredituar.

Rrjedhimisht, produkti bazë i ofruar dhe mostra e dorëzuar dëshmojnë se operatori ekonomik dhe prodhuesi posedojnë produktin dhe kapacitetin teknik për realizimin e furnizimit sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktues.

Logoja dhe numri serik janë elemente të personalizimit të produktit

Logoja zyrtare e Doganës së Kosovës dhe numri unik tetëshifror nuk ndryshojnë konstruksionin, materialin, dimensionet, mekanizmin e mbylljes, rezistencën apo funksionalitetin e pllombës.

Ato janë **elemente të personalizimit dhe identifikimit të produktit**, të cilat vendosen në produkt gjatë procesit të prodhimit përfundimtar/serik, sipas kërkesave të blerësit.

Në rastin konkret kjo është edhe më e rëndësishme, pasi kemi të bëjmë me:

logon zyrtare të një institucioni shtetëror – Doganës së Kosovës; dhe numërim unik tetëshifror të serisë së pllombave.

Këto elemente, për nga vetë natyra e tyre, duhet të koordinohen dhe përcaktohen me Autoritetin Kontraktues para prodhimit serik, përkatësisht pas lidhjes së kontratës dhe në përputhje me urdhër-blerjet dhe kërkesat konkrete të AK-së.

Kjo mbështetet edhe në dispozitat përkatëse të Kushteve të Kontratës, përfshirë **nenet 16 dhe 19**, të cilat rregullojnë realizimin e furnizimeve dhe kërkesat gjatë ekzekutimit të kontratës.

Është e paarsyeshme që mungesa e këtyre dy elementeve të personalizimit në një mostër të fazës së tenderimit të trajtohet në të njëjtën mënyrë sikur produkti të mos përmbushte karakteristikat esenciale teknike apo mekanike.

AK ka ngatërruar karakteristikat teknike të produktit me personalizimin e tij

Në rastin konkret duhet bërë dallim i qartë ndërmjet:

- a)** karakteristikave teknike, konstruktive, mekanike dhe funksionale të pllombës; dhe
- b)** elementeve grafike dhe identifikuese që aplikohen mbi produktin për nevojat specifike të blerësit.

Mostra jonë dëshmon përmbushjen e karakteristikave të kategorisë së parë.

Logoja e Doganës së Kosovës dhe numri unik tetëshifror i përkasin kategorisë së dytë dhe mund të aplikohen gjatë prodhimit serik pa ndryshuar në asnjë mënyrë produktin bazë të ofertuar.

Prandaj, mungesa e logos dhe serializimit në mostrën e tenderimit nuk dëshmon se OE nuk është në gjendje t'i realizojë këto kërkesa gjatë furnizimit.

Përkundrazi, anëtar i Grupit të OE-ve **“Shandong Haoyu Security Technology Co., Ltd.”** është **vetë prodhuesi i produktit të ofruar**, çka nënkupton se personalizimi i pllombave me logon e kërkuar dhe numërimin unik realizohet në kuadër të procesit të prodhimit.

Kërkesa duhet të interpretohet në përputhje me parimet e proporcionalitetit dhe konkurrencës

Nëse Dosja e Tenderit nuk ka përcaktuar në mënyrë të qartë dhe të pakushtëzuar se **vetë mostra që dorëzohet gjatë ofertimit duhet paraprakisht të prodhohet me logon zyrtare të Doganës së Kosovës dhe me numër unik tetëshifror të gravuar**, atëherë AK nuk mundet që pas hapjes së ofertave ta interpretojë këtë si kusht eliminues.

Një kriter eliminues duhet të jetë i qartë, transparent dhe i parashikueshëm për operatorët ekonomikë që në momentin e përgatitjes së ofertës.

Për më tepër, kërkesa që secili ofertues, ende pa u shpallur fitues dhe pa pasur kontratë me Doganën e Kosovës, të realizojë prodhim të posaçëm me logon zyrtare institucionale dhe serializim specifik, duhet të vlerësohet edhe nga aspekti i **proporcionalitetit dhe domosdoshmërisë së një kërkesë të tillë në fazën e tenderimit**.

Dispozitat e **nenit 28 të LPP-së**, që rregullojnë specifikimet teknike, duhet të zbatohen në mënyrë që kërkesat teknike të jenë të lidhura me objektin e kontratës dhe të mos krijojnë pengesa të pajustificuara për konkurrencën.

AK ka pasur mundësi të kërkojë sqarim, nëse ka konsideruar se ekziston paqartësi

Nëse AK ka pasur paqartësi nëse prodhuesi është në gjendje që gjatë prodhimit serik të aplikojë logon zyrtare dhe numrin unik tetëshifror përmes gravimit/markimit të kërkuar, kjo çështje duhej të trajtohej në përputhje me dispozitat për ekzaminimin dhe sqarimin e tenderëve, përfshirë **nenet 59 dhe 72 të LPP-së**, në masën në të cilën plotësohen kushtet ligjore për kërkimin e sqarimeve.

Një sqarim i tillë nuk do të ndryshonte produktin e ofertuar, çmimin, karakteristikat teknike apo ndonjë element material të ofertës, por vetëm do të konfirmonte aftësinë e prodhuesit për të realizuar personalizimin e produktit gjatë prodhimit serik.

Prandaj, eliminimi i menjëhershëm i ofertës për shkak të mungesës së dy elementeve të personalizimit në mostër, pa analizuar natyrën e tyre dhe dokumentacionin teknik të ofertës, përbën një qasje formaliste dhe joproporcionale.

Përfundim

Nga sa u argumentua më sipër, rezulton se mostra e dorëzuar përmbush karakteristikat esenciale fizike, teknike, konstruktive dhe mekanike të produktit të kërkuar, ndërsa **logoja e Doganës së Kosovës dhe numri unik tetëshifror përbëjnë elemente të personalizimit të produktit**, të cilat mund dhe duhet të aplikohen gjatë prodhimit serik sipas kërkesave konkrete të AK-së.

Për pasojë, AK nuk mund të barazojë mungesën e personalizimit të mostrës me mospërmbushjen teknike të vetë produktit, veçanërisht nëse në Dosjen e Tenderit nuk është përcaktuar në mënyrë të qartë se mungesa e logos dhe numrit tetëshifror **në vetë mostrën e dorëzuar në fazën e tenderimit** përbën shkak për eliminim.

KËRKESA

Kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që **Pretendimin Ankimor Nr. 2 ta aprovojë si të bazuar**, të konstatojë se eliminimi i ofertës sonë mbi bazën e mungesës së logos zyrtare të Doganës së Kosovës dhe numrit unik tetëshifror në mostrën fizike është bërë mbi një interpretim të gabuar dhe joproportional të kërkesave të Dosjes së Tenderit dhe të obligojë Autoritetin Kontraktues që ofertën tonë ta kthejë në rivlerësim dhe ta vlerësojë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe dispozitat përkatëse të LPP-së.

PROVAT:

1. Mostra fizike e pllombës e dorëzuar brenda afatit të tenderimit;
2. Raporti i testimit për përputhshmërinë me standardin ISO 17712:2013;
3. Dokumentacioni teknik/katalogu i prodhuesit;
4. Deklarata e Aneksi 1 – për përmbushjen e Specifikimeve Teknike, përfshi llogon me numrin tetëshifror në pllombë;
5. Fleta e të Dhënave të Tenderit;
6. Kushtet e Kontratës, përfshirë nenet 16 dhe 19;

Aneksi 1 nuk ka kërkuar që mostra e dorëzuar në fazën e tenderimit të jetë e personalizuar

Në Aneksin 1 është përcaktuar:

“Pllomba duhet të jetë me logo zyrtare të Doganës së Kosovës dhe të ketë numrin tetë shifror të gravuar.

Logoja e Doganës së Kosovës duhet të jetë e gravuar në ngjyrë të bardhë.

Gravurat duhet të bëhen duke shfrytëzuar teknologjinë e lartë laserike e cila pamundëson ndryshimin.

Pllomba duhet të ketë kaluar testimin sipas ISO standardeve të fundit për këtë lloj malli. Secili livrim i mallit do të rezultojë me verifikimin e artikujve me mostrat fizike sipas specifikimit teknik.

Autoriteti Kontraktues sipas nevojave mund të kërkojë nga Furnizuesi që tek numri identifikues tetë shifror të shtohen edhe shifra tjera.”

Nga formulimi i mësipërm rezulton qartë se Dosja e Tenderit përcakton **karakteristikat që duhet t'i ketë pllomba që do të furnizohet**, por në asnjë pjesë të këtij formulimi nuk është përcaktuar shprehimisht se:

“Mostra fizike e dorëzuar së bashku me ofertën duhet të përmbajë logon zyrtare të Doganës së Kosovës dhe numrin unik tetëshifror të gravuar.”

Ky dallim është thelbësor.

AK në fazën e vlerësimit nuk mund ta transformojë kërkesën **“Pllomba duhet të jetë...”** në një kërkesë tjetër, të paformuluar në Dosjen e Tenderit, sipas së cilës **“mostra e dorëzuar me ofertën duhet të jetë paraprakisht e personalizuar me logon dhe numrin e Doganës së Kosovës.”**

Nëse AK ka synuar që logoja dhe numri tetëshifror të jenë të vendosura edhe në mostrën fizike në momentin e ofertimit, një kërkesë e tillë është dashur të përcaktohej në mënyrë të qartë, të saktë dhe të pakushtëzuar në Dosjen e Tenderit.

Një kusht i cili nuk është përcaktuar shprehimisht si kërkesë për mostrën nuk mund të shndërrohet **pas hapjes së ofertave në kriter eliminues**.

2. Vetë Aneksi 1 e lidh personalizimin me fazën e furnizimit

Veçanërisht domethënëse është dispozita:

“Autoriteti Kontraktues sipas nevojave mund të kërkojë nga Furnizuesi që tek numri identifikues tetë shifror të shtohen edhe shifra tjera.”

Përdorimi i termit **“Furnizuesi”** dhe përcaktimi se AK mund të kërkojë, sipas nevojës, shtimin e shifrave të tjera, dëshmon se konfigurimi përfundimtar i numrit identifikues nuk është domosdoshmërisht i përcaktuar në momentin e ofertimit.

Përkundrazi, Dosja e Tenderit vetë parashikon mundësinë që AK gjatë realizimit të furnizimit të kërkojë modifikim/shtim të numrit identifikues.

Kjo e bën edhe më të pabazuar kërkesën që mostra e prodhuar para lidhjes së kontratës të përmbajë një konfigurim përfundimtar të personalizimit, kur vetë AK ka rezervuar të drejtën që këtë konfigurim ta ndryshojë sipas nevojave të tij.

3. Mostra e dorëzuar përmbush karakteristikat esenciale të produktit

Mostra fizike e dorëzuar nga Grupi ynë i Operatorëve Ekonomikë përputhet me parametrat esenciale fizikë, konstruktivë dhe mekanikë të produktit të kërkuar, përfshirë:

- materialin dhe konstruksionin e trupit;
- dimensionet e kërkuara;
- kabllon me gjatësi prej 30 cm;
- karakteristikat mekanike të pllombës;
- mekanizmin e bllokimit kundër kthimit prapa;

- karakteristikat funksionale dhe të sigurisë;
- si dhe përputhshmërinë me **ISO 17712:2013**, të dëshmuar me raport testimi nga laborator i akredituar.

Pra, nuk kemi të bëjmë me një produkt teknikisht tjetër apo me një mostër që nuk përmbush funksionin e kërkuar.

Elementet që AK pretendon se mungojnë janë **logoja institucionale dhe numri identifikues**, pra elemente të personalizimit të produktit, të cilat realizohen në procesin e prodhimit serik për blerësin konkret.

4. Logoja dhe serializimi nuk ndryshojnë produktin e ofertuar

Logoja zyrtare e Doganës së Kosovës dhe numri unik tetëshifror nuk ndryshojnë materialin, konstruksionin, dimensionet, kabllon, mekanizmin e mbylljes, rezistencën apo funksionalitetin e pllombës.

Ato janë elemente identifikuese që aplikohen përmes teknologjisë laserike gjatë procesit të personalizimit të produktit.

Anëtar i Grupit të OE-ve **“Shandong Haoyu Security Technology Co., Ltd.”** është vetë prodhuesi i **pllombave të ofruara**, dhe rrjedhimisht realizimi i gravimit laserik, logos dhe serializimit sipas kërkesave të AK-së është pjesë e procesit të prodhimit të mallrave që do të furnizohen.

Mostra e dorëzuar ka për qëllim të mundësojë identifikimin dhe verifikimin e produktit fizik të ofertuar. Personalizimi përfundimtar institucional realizohet mbi këtë produkt në procesin e prodhimit serik.

5. Vetë Aneksi 1 përcakton verifikimin gjatë livrimeve

Aneksi 1 përcakton shprehimisht:

“Secili livrim i mallit do të rezultojë me verifikimin e artikujve me mostrat fizike sipas specifikimit teknik.”

Kjo dispozitë është veçanërisht e rëndësishme.

Ajo tregon se mostrat fizike do të shërbejnë si **bazë/reference për verifikimin e artikujve gjatë realizimit të furnizimeve**.

Pra, gjatë çdo livrimi AK ka të drejtë dhe mundësi të kontrollojë nëse produkti i furnizuar përputhet me produktin e ofertuar dhe me specifikimin teknik, duke përfshirë edhe personalizimin e kërkuar për furnizimin përfundimtar.

Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës pllombat do të furnizoheshin pa logon e Doganës së Kosovës, pa numrin identifikues të kërkuar ose pa gravimin laserik të përcaktuar, atëherë AK do të kishte bazë të refuzonte mallin si të papërshtatshëm me specifikimin teknik.

Mirëpo, kjo është krejtësisht e ndryshme nga eliminimi i ofertuesit për faktin se **mostra e paraqitur para lidhjes së kontratës nuk është personalizuar paraprakisht me elementet institucionale të blerësit**, kur një detyrim i tillë për mostrën nuk është përcaktuar shprehimisht në Dosjen e Tenderit.

6. AK nuk mund të krijojë kriter eliminues përmes interpretimit pas hapjes së ofertave

Parimet themelore të prokurimit publik kërkojnë që operatorët ekonomikë të dinë paraprakisht dhe në mënyrë të qartë kushtet që duhet t'i plotësojnë ofertat e tyre.

Nëse AK ka konsideruar esenciale që **vetë mostra** të jetë e gravuar me logon zyrtare dhe numrin tetëshifror, ka qenë përgjegjësi e AK-së që këtë ta shkruajë qartë në Dosjen e Tenderit, për shembull:

“Mostra fizike e dorëzuar së bashku me tenderin duhet të përmbajë logon zyrtare të Doganës së Kosovës dhe numrin tetëshifror të gravuar me laser.”

Një formulim i tillë nuk ekziston në kërkesën e cituar.

Për këtë arsye, interpretimi i bërë vetëm në fazën e vlerësimit, duke e shndërruar një karakteristikë të produktit që do të furnizohet në një kusht eliminues për mostrën, cenon parimet e transparencës, trajtimit të barabartë dhe parashikueshmërisë së kërkesave të tenderit.

7. Në rast paqartësie, interpretimi nuk mund të bëhet në dëm të OE-së

Nëse AK konsideron se formulimi i Aneksit 1 mund të interpretohet në atë mënyrë që logoja dhe numri tetëshifror janë kërkuar edhe në mostër, atëherë vetë ekzistenca e një paqartësie të tillë dëshmon se kërkesa nuk është formuluar me qartësinë e nevojshme për t'u përdorur si bazë automatike për eliminim.

Një paqartësi e krijuar nga mënyra e hartimit të Dosjes së Tenderit nga vetë Autoriteti Kontraktues nuk duhet të interpretohet më pas në mënyrën më të pafavorshme për operatorin ekonomik dhe të përdoret si kriter eliminues që nuk është përcaktuar shprehimisht.

Nëse AK ka pasur dyshim lidhur me aftësinë e prodhuesit për realizimin e gravimit laserik, logos apo numërimit unik gjatë prodhimit serik, AK ka mundur të shqyrtojë mundësinë e kërkimit të sqarimeve në përputhje me dispozitat përkatëse të LPP-së, për aq sa një sqarim i tillë nuk do të ndryshonte materialisht ofertën.

Bazuar në sa më sipër, arsyetimi i AK-së se oferta jonë duhet të eliminohet sepse mostra fizike nuk përmban logon zyrtare të Doganës së Kosovës dhe numrin tetëshifror të gravuar është i **pabazuar**.

Aneksi 1 kërkon që pllomba që do të furnizohet të ketë këto karakteristika, por nuk përcakton shprehimisht që mostra e dorëzuar në fazën e tenderimit duhet të jetë paraprakisht e personalizuar me logon zyrtare dhe numrin tetëshifror.

Për më tepër, vetë Aneksi 1 parashikon që AK mund t'i kërkojë **Furnizuesit** shtimin e shifrave të tjera në numrin identifikues, çka dëshmon se konfigurimi përfundimtar i serializimit lidhet edhe me kërkesat e AK-së gjatë realizimit të furnizimit.

Mostra jonë përmbush karakteristikat esenciale teknike, fizike, mekanike dhe funksionale të produktit, ndërsa personalizimi me logon zyrtare dhe serializimi realizohen nga prodhuesi gjatë prodhimit serik sipas kërkesave përfundimtare të Autoritetit Kontraktues.

Kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që **Pretendimin Ankimor Nr. 2 ta aprovojë si të bazuar**, të konstatojë se AK ka interpretuar në mënyrë të gabuar dhe të zgjeruar kërkesat e Aneksit 1 duke krijuar një kusht eliminues që nuk është përcaktuar shprehimisht për mostrën fizike, dhe të obligojë Autoritetin Kontraktues që ofertën e Grupit tonë të OE-ve ta kthejë në **rivlerësim**, duke e vlerësuar në përputhje me kërkesat faktike të Dosjes së Tenderit dhe dispozitat e LPP-së.

PRETENDIMI ANKIMOR 3

Shkelja e kriterit për dhënie të kontratës dhe e parimit të përdorimit efikas dhe ekonomik të fondeve publike

Për këtë procedurë të prokurimit, Autoriteti Kontraktues – Dogana e Kosovës, në Dosjen e Tenderit ka përcaktuar si kriter për dhënien e kontratës:

“Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët.”

Grupi ynë i Operatorëve Ekonomikë **“PROGLOBAL” SH.P.K. & “Shandong Haoyu Security Technology Co., Ltd.”** ka dorëzuar ofertë financiare në vlerë totale prej: **89,540.00 EUR**

ndërsa Operatorin Ekonomik të rekomanduar për dhënie të kontratës, **“Bujar I. Kabashi” B.I.**, AK e ka rekomanduar me ofertën në vlerë prej: **104,500.00 EUR**.

Diferenca ndërmjet këtyre dy ofertave është:

104,500.00 EUR – 89,540.00 EUR = 14,960.00 EUR.

Pra, oferta e rekomanduar nga AK për kontratë është **14,960.00 EUR më e shtrenjtë** se oferta e Grupit tonë të Operatorëve Ekonomikë.

Kjo diferencë nuk është e parëndësishme, por paraqet një kosto shtesë prej **14,960.00 EUR për buxhetin publik**, e cila do të mund të evitohej nëse oferta jonë do të vlerësohej drejt dhe në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe dispozitat e LPP-së.

Theksojmë se ky pretendim nuk mbështetet vetëm në faktin se oferta jonë ka çmim më të ulët. Përkundrazi, ai duhet të shqyrtohet në lidhje të drejtpërdrejtë me **Pretendimet Ankimore Nr. 1 dhe Nr. 2**, përmes të cilave kemi argumentuar se arsyet e përdorura nga AK për eliminimin e ofertës sonë janë të pabazuara.

Nëse konstatohet se Grupi ynë i OE-ve është eliminuar në mënyrë të kundërligjshme, atëherë pasoja e drejtpërdrejtë e këtij vlerësimi të gabuar është rekomandimi për kontratë i një oferte **14,960.00 EUR më të shtrenjtë**.

Në këtë mënyrë, veprimi i AK-së nuk cenon vetëm të drejtat dhe interesin juridik të Grupit tonë të OE-ve, por prodhon edhe pasoja konkrete financiare për Autoritetin Kontraktues dhe për përdorimin e fondeve publike.

Sipas **nenit 6 të LPP-së**, Autoriteti Kontraktues ka për obligim që gjatë ushtrimit të aktiviteteve të prokurimit të sigurojë përdorimin sa më efikas, transparent dhe të drejtë të fondeve dhe burimeve publike, duke marrë parasysh qëllimin dhe objektin e prokurimit.

Në rastin konkret, kriteri i përcaktuar paraprakisht nga vetë AK është **“Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët”**.

Rrjedhimisht, në momentin kur oferta jonë konstatohet si e përgjegjshme, AK është e obliguar që kriterin për dhënie të kontratës ta zbatojë në mënyrë të njëjtë dhe objektive ndaj të gjithë operatorëve ekonomikë.

AK nuk mund të eliminojë një ofertë më të lirë mbi bazën e konstatimeve të pambështetura në dokumentacionin e tenderit dhe më pas ta përdorë këtë eliminim si bazë për rekomandimin e një oferte dukshëm më të shtrenjtë.

Në rastin konkret, dallimi financiar prej **14,960.00 EUR** paraqet edhe një pasojë konkrete të shkeljeve të pretenduara në këtë ankesë.

Për më tepër, oferta e rekomanduar për kontratë është afërsisht **16.7% më e shtrenjtë se oferta jonë**, çka e bën edhe më të rëndësishëm ekzaminimin e plotë dhe të ligjshëm të arsyeve mbi të cilat është eliminuar Grupi ynë i OE-ve.

Nëse eliminimi ynë është bërë në kundërshtim me LPP-në dhe Dosjen e Tenderit, atëherë rekomandimi për kontratë i ofertës prej 104,500.00 EUR, në vend të ofertës sonë prej 89,540.00 EUR, është në kundërshtim edhe me qëllimin e përcaktuar në **nenin 6 të LPP-së për përdorimin efikas dhe ekonomik të fondeve publike**.

Duke marrë parasysh argumentet e paraqitura në Pretendimet Ankimore Nr. 1, Nr. 2 dhe Nr. 3, kërkojmë nga **Organi Shqyrtues i Prokurimit** që:

- ta aprovojë këtë pretendim ankimor si **të bazuar**;
- të konstatojë se eliminimi i Grupit tonë të OE-ve ka ndikuar drejtpërdrejt në rezultatin e procedurës së prokurimit;
- të anulojë vendimin/njoftimin e AK-së për rekomandimin e OE-së për kontratë;
- ta kthejë aktivitetin e prokurimit në **rivlerësim**;
- ta obligojë AK-në që gjatë rivlerësimit të marrë në konsideratë të gjitha dëshmitë e dorëzuara nga Grupi ynë i OE-ve dhe të zbatojë kriterin e përcaktuar në Dosjen e Tenderit – **“Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët”** – në përputhje me dispozitat e LPP-së.

Prandaj Bazuar në argumentet e mësipërme faktike dhe ligjore, kërkojmë që të nxjerrni këtë:

VENDIM

- I. Te aprovohet**, kërkesa për ri shqyrtim e liderit të grupit OE Progloal shpk, në tërësi si e bazuar
- II. Te anulohet**, njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues formualri B58, i datës 12.08.2026, si i kundërligjeshëm dhe lënda të kthehet në rivlerësim
- III. Te rekomandohet** për kontratë grupi yne si ofertuesi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët konform nenit 60 të LPP-së.

Në të kundërtën, kompania jone detyrimisht të drejtat tona do t'i raportojë në organet tjera kompetente për veprime kundërligjore të tilla dhe shkelje të parimeve të Prokurimit Publik dhe jo vetëm në OSHP, pasi që komisioni vlerësues i ofertave ka shkelur në tërësi dispozitat ligjore në fuqi dhe ka shkelur parimet bazike të prokurimit, marrë parasysh faktin se me dispozitat e nenit 59.1, të LPP-së përgjegjësia për vlerësim ekzaminim dhe krahasim të ofertave është individuale e secilit anëtar të komisionit vlerësues.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Te konsiderueshme dhe të cilat në tërësi do të kalkulojnë dhe të kompensohen.

10. Lista e dokumenteve (dëshmi) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-së,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-së, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.
- h) ***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'i dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'i dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.